



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit / Opština Orahovac / Municipality of Rahovec
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
Odeljenje za Kultur, Omladinu i Sport
Department of Culture, Youth and Sport



13 Nr. Zyrtar – 2022

Udhëzimet për Aplikantët

Klubet, Shoqatat, OJQ-të, për organizimin e aktiviteteve Sportive

Data e hapjes së thirrjes: 04/03/2022

Afati i fundit për aplikim: 24/03/2022

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport / Odeljenje za Kultur, Omladinu i Sport / Department of Culture, Youth and Sport
Adresa: Tetë dëshmorët e Pashtrikut / Tel: +38344339035 / Email: afrim.dina@rks-gov.net

**MBËSHTETJE FINANCIARE PËR PROJEKTET E KLUBEVE, OJQ-ve,
SHOQATAVE, NË FUSHËN SPORTIT:**

Komuna e Rahovecit kujdeset për jetën sportive.

Me këtë synim Komuna e Rahovecit ofron përkrahje për klube, shoqata, OJQ-të me aftësi të posaçme kreative, në fushën e sportit dhe ofron mbështetjen e tyre me transparencë të plotë dhe pa kurrfarë diskriminimi.

Në këtë vijë, Komuna e Rahovecit synon pasurimin e jetës sportive të qytetit dhe fshatrave rritjen e llojllojshmërisë së aktiviteteve, tërheqjen e numrit sa më të madh të publikut në aktivitete, masivizimin e sportit, tërheqjen e sa më shumë sportistëve në këto aktivitete të krijuara si dhe në promovimin e sportit dhe aktiviteteve të të gjithë qytetarët.

Komuna po ashtu ka për synim ngritjen e cilësisë së programeve sportive përmes prezantimit të eksperiencave dhe përvojave më të mira ndërkombëtare në vendin tonë.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport / Odeljenje za Kulturu, Omladinu i Sport / Department of Culture, Youth and Sport
Adresa: Tetë dëshmorët e Pashtrikut / Tel: +38344339035 / Email: afirm.dina@rks-gov.net

OBJEKTIVAT E THIRRJES DHE PRIORITETET PËR NDARJEN E FONDEVE:

Objekti/objektivat e përgjithshme të kësaj Thirrje është që Komuna e Rahovecit ofron përkrahje për Klubet, Shoqatat, me aftësi të posaçme kreative, në fushën e sportit dhe ofron mbështetjen e tyre me transparencë të plotë dhe pa kurrfarë diskriminimi.

Objektivat specifike të kësaj Thirrje janë:

Promovimi dhe afirmimi i vlerave sportive .

Mbështetje financiare publike do të kenë:

Të gjithë Klubet, Shoqatat, që veprojnë në Komunës e Rahovecit.

VLERA PLANIFIKUAR E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR PROJEKTET DHE TOTAL I THIRRJES:

1. Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt individual është **350 € euro**, ndërsa shuma maksimale për një projekt është **20.000 €**.

Drejtoria për Kulturë, Rinë dhe Sport / Odeljenje za Kulturu, Omladinu i Sport / Department of Culture, Youth and Sport
Adresa: Tetë dëshmorët e Pashtrikut / Tel: +38344339035 / Email:afirm.dina@rks-gov.net

KUSHTET FORMALE TË THIRRJES:

Aplikuesit e pranueshëm: kush mund të aplikoj?

1. Të gjithë OJQ-të aplikuese që janë të regjistruara në Ministrinë e Administratës Publike - (për të dëshmuar këtë kërkesë, OJQ-ja aplikuese duhet të dërgoj kopjen e certifikatës së regjistrimit me rastin e aplikimit);
2. Të ketë zotësi juridike, financiare dhe operationale për zbatimin e projektit;
3. OJQ-të, Klubet, shoqatat, të cilët veprimtaria e tyre është e fokusuar në fushën e sportit dhe aktivitetet e zhvillojnë në Komunën e Rahovecit;
4. Të ketë kryer të gjitha detyrimet tatimore dhe kontributet tjera të detyrueshme në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.
5. Të mos jetë në proces falimentimi, në proces të shuarjes, në procedura të mbledhjes së detyrueshme apo likuidimit;
6. Të gjithë aplikuesit që i kanë përmbyllur projektet paraprake të mbështetura nga Komuna e Rahovecit.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport / Odeljenje za Kulturu, Omladinu i Sport / Department of Culture, Youth and Sport
Adresa: Tetë dëshmorët e Pashtrikut / Tel: +38344339035 / Email: afrim.dina@rks-gov.net

Nuk kanë të drejtë për të konkurruar sipas kësaj thirrje:

1. Të gjithë aplikuesit që nuk i kanë përmbyllur projektet paraprake të mbështetura nga Komuna e Rahovecit;
2. OJQ-të, Klubet, Shoqatat e falimentuara;
3. Klubet, Shoqatat, Individët, OJQ-të, të cilat mund të kenë konflikt interesi;
4. Klubet, Shoqatat, Individët, OJQ-të që nuk janë nga Komuna e Rahovecit;

Një aplikant mund të paraqesë vetëm një kërkesë për aplikim.

Aktivitetet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes:

1. Kohëzgjatja e planifikuar e projekteve është deri në muajin dhjetor 2022.
2. Aktivitetet e projektit duhet të kryhen brenda territorit të Komunës së Rahovecit.
3. Aktivitetet e pranueshme të projektit mund të përfshijnë:
 - a) Kërkesat nga Klubet Sportive;
 - b) Kërkesat nga Shoqatat;

Llojet e mëposhtme të aktiviteteve nuk janë të pranueshme për financim:

1. Aktivitete që nuk zhvillohen në Komunën e Rahovecit;
2. Aktivitete që përmbajnë diskriminim gjinor;
3. Aktivitete që përmbajnë diskriminim fetar;

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport / Odeljenje za Kulturu, Omladinu i Sport / Department of Culture, Youth and Sport
Adresa: Tetë dëshmorët e Pashtrikut / Tel: +38344339035 / Email: afrim.dina@rks-gov.net

Shpenzimet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes:

Përmes fondeve publike të kësaj thirrje publike mund të financohen vetëm kostot reale dhe të pranueshme për realizimin e aktiviteteve të projektit, në periudhën kohore të specifikuar me këto udhëzime.

Në vlerësimin e projektit/programit do të vlerësohen vetëm kostot e nevojave në lidhje me aktivitetet e planifikuara, si dhe në lartësinë reale të këtyre shpenzimeve.

Shpenzimet e drejtpërdrejta të pranueshme :

Shpenzimet sipas kostove të pranueshme direkte përfshijnë shpenzimet që janë direkt të lidhura me zbatimin e disa aktiviteteve projektit ose të programit të propozuar, të tilla si:

1. Shpenzimet rreth organizimit i aktiviteteve;
2. Material shpenzues;
3. Sigurimi i sallave, shpenzimet e zërimit, ndriçimit;
4. Transporti
5. Pjesëmarrjen në gara vendore, ndërkombëtare, pjesëmarrje në turne,
6. Shpenzimet e komunikimit (shpenzimet e telefonit, internetit),
7. Shërbime grafike (shërbimet për shtypjen e fletushkave, broshurave, revistave, duke specifikuar llojin e qëllimin e shërbimit, sasinë, çmimin e njësisë, etj;)
8. Kosto të tjera që lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e aktiviteteve të projektit apo programit.

Shpenzimet e papranueshme :

Shpenzimet e papranueshme përfshijnë:

1. Renovime;
2. Dhurata, shpërblime të ngjashme;
3. Shpenzimet për ushqim dhe pije;

SI TË APLIKONI?

Lista e dokumenteve të detyrueshme të thirrjes publike:

- Formulari i aplikacioni të plotësohet në Word
- Formulari i buxhetit të plotësohet në Word
- Deklarata e financimit të dy fisht të plotësohet në Word

Aplikacioni i projekt propozimit :

Plotësimi i formularit të projekt propozimit është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm. Ajo përmban të dhëna në lidhje me aplikuesin dhe partnerët si dhe të dhëna mbi përmbajtjen e projektit/programit për të cilin kërkohet financim nga burimet publike.

Në rast se në formën e dorëzuar mungojnë të dhënat në lidhje me përmbajtjen e projektit, aplikimi nuk do të merret në konsideratë.

Drejtoria për Kulturë, Rinë dhe Sport / Odeljenje za Kulturu, Omladinu i Sport / Department of Culture, Youth and Sport
Adresa: Tetë dëshmorët e Pashtrikut / Tel: +38344339035 / Email:afirm.dina@rks-gov.net

Përmbajtja e formës Buxhetit:

Formulari i propozim Buxhetit është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm. Propozim Buxheti i dorëzuar duhet të përmbaj informacion për të gjitha shpenzimet direkte të projektit/programit të propozuar për financim.

Nëse forma e buxhetit nuk është e plotësuar në tërësi, nuk do të merret në konsideratë.

Ku ta dorëzoni aplikimin?

- Aplikacionin duhet ta dorëzoni në 3 kopjeve fizike në sportelin nr.7, kati i parë në objektin e komunës së Rahovecit Rr. Tetë Dëshmorët e Pashtrikut p.n, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00
- Aplikacionet në formë tjetër nuk pranohen.
- Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike, mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: arsim.a.kastrati@rks-gov.net, dhe në numrin e telefonit +383 44834474. Pyetjet mund të bëhet deri më 21.03.2022.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport / Odeljenje za Kulturu, Omladinu i Sport / Department of Culture, Youth and Sport
Adresa: Tetë dëshmorët e Pashtrikut / Tel: +38344339035 / Email: afirm.dina@rks-gov.net

VLERËSIMI DHE NDARJA E FONDEVE:

Aplikacionet e pranuara do të kalojnë nëpër procedurën e mëposhtme:

Komuna e Rahovecit do të themeloj një komision vlerësues të përbërë nga 5 anëtarë nga zyrtar të institucionit dhe ekspert tjerë të jashtëm, i cili ka për detyrë të vlerësoj aplikacionet nëse i plotësojnë kushtet formale të thirrjes publike.

Pas kontrollimit të gjitha aplikacioneve të pranuara, komisioni do të përgatis një listë të gjitha aplikantëve, që i plotësojnë kushtet për tu vlerësuar përmbajtja e projekteve të tyre, dhe një listë të aplikantëve të cilët nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

Komuna e Rahovecit do të njoftojë me shkrim të gjithë aplikantët të cilët nuk i plotësojnë kërkesat dhe arsyet e refuzimit të aplikimit të tyre.

Njoftimi i aplikuesve - Të gjithë aplikantët, aplikimet e të cilëve kanë hyrë në procesin e vlerësimit do të jenë të informuar në lidhje me vendimin për ndarjen e projekteve.

KALENDARI INDIKATIV I REALIZIMIT TË THIRRJES

Fazat e procedurës së thirrjes:

1. Afati i fundit për aplikimet **24.03.2022**;
2. Afati i fundit për dërgimin e pyetjeve në lidhje me thirrjen **21.03.2022**

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport / Odeljenje za Kulturu, Omladinu i Sport / Department of Culture, Youth and Sport
Adresa: Tetë dëshmorët e Pashtrikut / Tel: +38344339035 / Email:afrim.dina@rks-gov.net


LISTA E DOKUMENTEVE TË THIRRJES PUBLIKE

Për Ojq-të dhe shoqatat sportive

- ❖ Certifikata e regjistrimit të OJQ-së;
- ❖ Certifikata e nr. fiskal;
- ❖ Vërtetimi/Konfirmimi i llogarisë bankare të OJQ-së (nuk pranohet kopje ekartelës bankare);
- ❖ Kopjen e letërnjoftimit/ pasaportës të përfaqësuesit të OJQ-së.
- ❖ Vërtetimi i ATK-së
- ❖ Vërtetimi i DKRS-së për mbylljen e raportit për vitin paraprak fiskal
- ❖ Deklarata e dyfishtë e financimit

Vërejtje/Kujdes: Të gjitha aplikimet të cilat nuk do të kenë dokumentacionin e kompletuar nuk do të merren parasysh.

Rahovec, mars 2022



Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport / Odeljenje za Kultur, Omladinu i Sport / Department of Culture, Youth and Sport
Adresa: Tetë dëshmorët e Pashtrikut / Tel: +38344339035 / Email: afrim.dina@rks-gov.net